

KOSOVA REISEN

Löwenstr. 69

CH-8001 Zurich

Schweiz

Pronar: Besnik Sadrija

Nr. i firmës:

1. Juridiksioni i kushteve të përgjithshme të biznesit

Të gjitha shërbimet e KOSOVA REISEN (më tutje KR) pasojnë vetëm në bazë të kushteve të përgjithshme të biznesit në vijim. Përjashtimet nga këto kushte të biznesit janë te vlefshme, vetëm atëherë kur janë bërë si marrëveshje me shkrim dhe janë vërtetuar nga ne, po ashtu me shkrim.

2. Oferta dhe lidhja e kontratës

Ofertat për sistemin online të rezervimit paraqesin kërkesë të detyrueshme për klientin. Me regjistrimin përmes formularit online për rezervim, klienti lidhet detyrimisht gjatë përmbylljes së një kontrate për transport me kushtet valide për transportim të KOSOVA REISEN. Me pranimin nga ana eKR, vjen deri te lidhja e kësaj kontrate për transportim. KR deklaron pranimin e rezervimit, ne rastin kur e dërgon konfirmimin e rezervimit nepermjet një E-maili ose me ngarmikin e kreditkartes tuaj.

3. Kushtet e pagesës

Vlejnë çmimet, të cilat kanë qenë prezente e janë konfirmuar gjatë rezervimit. Paga realizohet vetëm nëpërmes një kreditkarte të pranuar nga KR. Pas pranimit të konfirmimit të rezervimit, i gjithë çmimi i biletës duhet të paguhet, gjë që ndodh dhe me këtë ngarkohet kontoja e kreditkartës së dhënë. Nëse banka ose instituti i kreditkartelave e refuzon pagesën, KOSOVA REISEN është e autorizuar që ta ndërpresë menjëherë kontratën dhe që ta anulojë rezervimin. Me këtë rast për secilin pasagjer ngrihet pagesa në vlerë prej 30.00 Sfr, si pagesë që krijohet me përpunimin e rastit.

4. Premtim për konfidencialitet

KOSOVA REISEN garanton konfidencialitet të plotë për të gjitha të dhënat e pranuar nga Klienti.

5. Dokumentet e udhëtimit

Pasagjeri merr nepermjet emailit konfirmim e rezervimit te cilen e perdor edhe si bilete udhëtimi. Një udhëtim, pa dokument valid për udhëtim, nuk është i pranueshëm. Biletat e aeroplanit, në rastin kur para nisjes shihet se shënimet dhe/ose emri nuk janë të njëjta me të dhënat personale të pasagjerit të dhëna gjatë rezervimit, nuk mund të pranohen si dokumente valide të udhëtimit. Pasagjerët me ndryshime të bëra në biletat e fluturimit/numrat e rezervimit përjashtohen nga fluturimi. Për ata vlen çmimi i tërësishëm i biletës. Për rridhënie e biletave, të cilat kanë humbur apo për raste të tjera, të cilat shkaktohen pa ndikimin e KOSOVA REISEN, ne e ngrisin një shumë për përpunim të rastit në vlerë prej 30.00 Sfr për secilin biletë fluturimi. Për përmbylljen dhe zbatimin e rregullave për hyrje në shtetet tjera, për pasaporta dhe për viza, secili pasagjer e mban përgjegjësinë për vete. KOSOVA REISEN është e autorizuar që pasagjerit t'ia llogarisë dhe t'ia vë në faturë çdo shpenzim eventual, që krijohet si pasojë e mospërmbylljes së këtyre rregullave.

6. Ndërrim-rezervimi/Anulimet

Ndërrim-rezervimit dhe ndërrimet e emrave mund të bëhen sipas dispozicionit dhe pas pagesës së një shume të caktuar për ndërrim-rezervim, gjegjësisht për anulim dhe ato mund të bëhen me shkrim nga larg e afër, si dhe me gojë, me dhënie e numrit të rezervimit para ditës së fluturimit, gjatë orarit të punës në numrat e telefonit, faksit apo tek adresa që gjendet në faturë/konfirmimin e rezervimit.

Anullimet e fluturimit behen te mundura vetem me kerkes me shkrim Email (info@kosovareisen.com) ose nepermjet faksit (Faks: +41 44 215 20 25) ne dite pune deri ne oren 18:00. Anullimet te cilat behen te djelave ose dite festash perpunohen dite e pare te punes. Per anulim merret parasysht vetem dita ne te cilen KOSOVA REISEN e merr kete kerekes.

Anullimet:

- 48 ore para fluturimit: 50.00 Sfr per çdo pasagjer

- 24 ore para fluturimit: 100.00 Sfr per çdo pasagjer

- me pak se 24 h para fluturimit: 100% të çmimit të biletës.

Për anulime në ditën e fluturimit, llogaritet çmimi i tërësishëm i biletës (100% i çmimit të biletës). Për mosparaqitje në udhëtim (No Show) llogaritet i tërë çmimi i biletës.

Ndërrim-rezervimit:

Për ndërrim-rezervim llogaritet shuma prej 50.00 Sfr. Po ashtu e aplikueshme është përveç 50 Sfr. për ndërrim date edhe tarifa e biletës për kohën të cilën e bëni rezervimin.

Ndërrimet e emrave pasi të ketë kaluar koha e dita e fluturimit nuk pranohen.

7. Koha për Check-in

KOSOVA REISEN i këshillon pasagjerët që të paraqiten tek sporteli përkatës për përgatitje të pasagjerëve më së voni 120 minuta para nisjes. Përgatitja e pasagjerëve mbyllet 40 minuta para nisjes së aeroplanit. KOSOVA REISEN nuk mban përgjegjësi për paraqitje të mëvonshme. Pasagjeri është vetë përgjegjës për arritjen me kohë të aeroplanit, për fluturimet tjera lidhëse dhe shërbimet me pagesë që marrin/presin udhëtarët.

8. Konfirmimi i kthimit

Çdo klient i KOSOVA REISEN është i detyruar ta konfirmojë kthimin e tij të planifikuar brenda 24 deri 48 orëve, nëpërmjet telefonit tek KOSOVA REISEN. Konfirmimet e kthimeve mund të bëhen në numrat e telefonit që gjenden në biletë. Nëse nuk e konfirmoni kthimin dhe ai ju humb, atëherë shuhet e drejta për fluturim.

9. Bagazhi dhe dokumentacioni

Limiti i lejuar për bagazh për secilin pasagjer (asnjë bagazh i lejuar për foshnje) që paguan është 20. Nuk është e mundur që bagazhin e pashfrytëzuar ta bartni tek pasagjerët tjerë. Vetëm pasagjerët, të cilët kanë rezervuar njëkohësisht bashkë, mund t'i vendosin bashkërisht limitet e tyre të lejuara për bagazh. Bagazhi me mbipeshë mund të transportohet pas kryerjes së pagesës së paraparë, sipas tarifave për bagazh me mbipeshë. Marrja me vete e mbipeshës nuk mund të garantohet. Për përmbylljen dhe zbatimin e rregullave për hyrje në shtetet tjera, për pasaporta dhe për viza, secili pasagjer e mban përgjegjësinë për vete. Pasagjeri duhet të marrë vetë përsipër çdo shpenzim eventual, që krijohet si pasojë e mospërmbylljes së këtyre rregullave.

10. Lirime për fëmijë dhe të rinj

Fëmijët deri në 2 vjeç (pa të drejtë kërkesë për ulëse) dhe të rinjtë deri në moshën 11 vjeçare paguajnë një çmim më të lirë. Me rëndësi është moshë e fëmijës gjatë nisjes. KOSOVA REISEN e ka të drejtën që para nisjes ta kontrollojë moshën e fëmijës dhe ta ngritë tarifën përkatëse.

11. Tjetërsimi

Tjetërsimet e kërkesave kundër KOSOVA REISEN janë të paefektshme.

12. Reklamimet

Reklamimet mund të bëhen në mënyrë të shkruar menjëherë pas përfundimit të fluturimit tek adresa në vijim: "KOSOVA REISEN"

Kundenservice

Löwenstr. 69

CH-8001 Zurich

13. Vendi i arbitrazhit

Vendi i arbitrazhit është Zürich.

14. Klausola salvatoriane

Në qoftë se klausola të veçanta të rregulloreve të dala janë tërësisht apo pjesërisht të paefektshme, atëherë validiteti i rregulloreve të tjera mbetet i paprekur nga kjo. Rregullorja e paefektshme zëvendësohet me një rregullore, e cila për nga qëllimi dhe kuptimi i rregullores së paefektshme është më e përafërt juridikisht dhe ekonomikisht.

15. Qëndrimi

Këto kushte i përkasin qëndrimit të datës 01.01.2011.

| | | | | | |
|-----------------------|------------------------------|--------------------------------------|-------------------------|------------------|-------------------------|
| KOSOVA REISEN | Kontakt | Internet | KOSOVA REISEN | Gjakovë | +381 390 321 091 |
| Löwenstr. 69 | Tel: +41 44 215 20 20 | E-Mail: info@kosovareisen.com | Nena Terez p.n. | Pejë | +381 39 432 471 |
| CH-8001 Zurich | Fax: +41 44 215 20 25 | Web: www.kosovareisen.com | KS-50000 Gjakovë | Prizren | +381 29 242 110 |
| Schweiz | Mob: +41 79 815 20 20 | | Kosovë | Prishtinë | +381 38 241 111 |